



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare

Vrojtimi i Besimit të Bizneseve dhe të Konsumatorëve

Shpjegime metodologjike

(Korrik, 2008)

Përmbajtja:

1. Karakteristika të përgjithshme	3
2. Mbledhja dhe përpunimi i informacionit	4
2.1 Kampioni-zgjedhja.....	4
2.2 Agregimi i të dhënave	4
2.3 Llogaritja e balancave	5
3. Llogaritja e treguesve të agreguar të besimit	5
3.1 Treguesi i Besimit të Industrisë	6
3.2 Treguesi i Besimit të Ndërtimit.....	7
3.3 Treguesi i Besimit të Shërbimeve	7
3.4 Treguesi i Besimit të Konsumatorëve.....	8
3.5 Treguesi i Tendencës Ekonomike	8
4. Publikimi i rezultateve	10
Aneks 1.	11
Aneks 2.	16

Fjalor i shkurtimeve:

VBB	Vrojtimi i Besimit të Bizneseve
VBK	Vrojtimi i Besimit të Konsumatorëve
TTE	Treguesi i Tendencës Ekonomike
TBI	Treguesi i Besimit të Industrisë
TBN	Treguesi i Besimit të Ndërtimit
TBSH	Treguesi i Besimit të Shërbimeve
TBK	Treguesi i Besimit të Konsumatorit
KE	Komisioni Evropian

*Komentet lidhur me këtë material mund të nisen me email në adresën:
parashikimi@bankofalbania.org*

1. Karakteristika të përgjithshme

Banka e Shqipërisë, duke filluar nga viti 2002, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, zhvillon vrojtimin e besimit të bizneseve (VBB) dhe vrojtimin e besimit të konsumatorëve (VBK), me synimin për të vlerësuar aspekte të ndryshme të aktivitetit ekonomik të bizneseve dhe të konsumatorëve familjarë. VBB dhe VBK zhvillohen me periodicitet tremujor. Pyetëtorët e të dy vrojtimitëve përbëhen kryesisht nga pyetje cilësore¹ që mundësojnë dhënien e opinioneve të firmave dhe konsumatorëve mbi zhvillimet ekonomike në të kaluarën dhe prritjet për të ardhmen.

Pyetëtori i VBB përbëhet nga 30 pyetje të grupuara në 7 kategori kryesore, si më poshtë (shih aneksi 1, Pyetëtori i Bizneseve):

- klime e përgjithshme e biznesit (pyetjet 1 dhe 2);
- aktiviteti i përgjithshëm i firmës (pyetjet 3-11);
- inventarët (pyetjet 12-13);
- çmimet e prodhimit (pyetjet 14-15);
- tregu i punës (pyetjet 16-21);
- konkurrenca dhe gjendja financiare (pyetjet 22-23);
- shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese (pyetjet 24-31).

Pyetëtori i VBK përbëhet nga 15 pyetje të grupuara në 4 kategori kryesore, si më poshtë (shih aneksi 1, Pyetëtori i Konsumatorëve):

- gjendja financiare (pyetjet 1 dhe 2);
- gjendja e përgjithshëm ekonomike (pyetjet 3-5.2);
- priritjet mbi ecurinë e çmimeve (pyetjet 6.1-7);
- shpenzimet dhe kursimi (pyetjet 8-13).

Qëllimi kryesor i vrojtimitëve VBB dhe VBK është mbledhja e informacionit sa më të plotë dhe në kohë mbi zhvillimet e ekonomisë në vend. Informacioni i mbledhur nëpërmjet vrojtimitëve përdoret për të ndërtuar tregues për sektorë të veçantë të ekonomisë dhe treguesin e tendencës ekonomike. Treguesit e ndërtuar përmbushin nevojën për një shkallë më të gjerë informacioni si në procesin e brendshëm vendimmarrës në bankë ashtu edhe nevojën për informim të agjentëve të ndryshëm ekonomikë. Përdorimi i rezultateve të vrojtimitëve të besimit siguron ndërtimin e serive kohore, të cilat jo vetëm plotësojnë bashkësinë e të dhënave zyrtare ekzistuese, por edhe bëjnë të mundur ndërtimin e treguesve që përafrojnë informacionin zyrtar, i cili publikohet me vonesë kohore dhe mund të jetë subjekt i rishikimit. Rezultatet e vrojtimitëve të besimit nuk rishikohen, pasi ardhja e informacionit për çdo fazë të vrojtimit ndalon me përfundimin e fazës përkatëse. Të dhënat e vrojtimitëve janë të nevojshme jo vetëm për përgatitjen e analizave ekonomike, por edhe për parashikimin e treguesve të ndryshëm të ekonomisë, duke ndihmuar procesin e vendimmarrjes të Bankës së Shqipërisë.

¹ Pyetjet cilësore kërkojnë nga i intervistuari një përgjigje në formën e një opinioni, perceptimi apo gjykimi për zhvillime të shkuara apo zhvillime të pritura, për aspekte të ndryshme, në ndryshim nga pyetjet sasiore të cilat kërkojnë nga i intervistuari të përgjigjet me një numër - të dhëna sasiore.

Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar me INSTAT-in për përcaktimin e karakteristikave të zgjedhjes, duke përfshirë dhe shtrirjen gjeografike të saj. Aktualisht INSTAT-i mbulon anketimin në terren të subjekteve dhe mbledhjen e pyetësorëve. Kontrolli, hedhja dhe përpunimin i rezultateve të vrojtimit realizohen pranë Bankës së Shqipërisë. Agregimi i informacionit cilësor të përfutur nga përgjigjet e pyetësorëve bëhet fillimisht në nivel sektori, dhe më pas për të gjithë ekonominë (shih pjesa 3.5). Ndryshimet cilësore të pyetësorëve dhe të metodologjisë së agregimit të të dhënave kanë synuar përafrimin më të madh me pyetësorët dhe metodologjinë e përdorur nga Komisioni Evropian.

Rezultatet e vrojtimit VBB dhe VBK reflektojnë vetëm prirjen e treguesve të perceptuar nga bizneset dhe nga konsumatorë, ato nuk pasqyrojnë gjykimet e Bankës së Shqipërisë. Treguesit e agreguar për sektorë të ndryshëm dhe për ekonominë në përgjithësi, nuk janë zëvendësues të statistikave sasiore zyrtare.

2. Mbledhja dhe përpunimi i informacionit

2.1 *Kampioni-zgjedhja*

Përcaktimi i kampionit të një vrojtimit ka të bëjë me zgjedhjen e subjekteve individuale që intervistohen. Përzgjedhja e subjekteve bëhet në bazë të një ose disa karakteristikave të kërkuara, në mënyrë që tërësia e këtyre subjekteve të përzgjedhura të përfaqësojë sa më mirë popullatën ose bashkësinë e të gjithë këtyre subjekteve në rang rajonal, apo kombëtar.

Përcaktimi i zgjedhjes së ndërmarrjeve dhe të konsumatorëve është bazuar në parimin e përfaqësimit sa më të mirë të popullatës. Për sa i përket vrojtimit të konsumatorëve, zgjedhja u përcaktua mbështetur në të dhënat për regjistrimin e popullsisë së vitit 2001 nga INSTAT-i. Kampioni i vrojtimit të bizneseve u mbështet në listën e bizneseve që INSTAT përdor për Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike (ASNE).

VBB dhe VBK përdorin një kampion të fiksuar biznesesh² dhe konsumatorësh në çdo fazë të vrojtimit. Madhësia aktuale e kampionit është 680 biznese për VBB dhe 1200 konsumatorë për VBK.

2.2 *Agregimi i të dhënave*

Agregimi i të dhënave fillon me agregimin e përgjigjeve për çdo pyetje. Përgjigjet për çdo pyetje numërohen dhe shprehen si përqindje ndaj numrit total të bizneseve që i janë përgjigjur asaj pyetjeje. Për shembull, në pyetjet me 3 alternativa, shprehen përgjigjet pozitive (P), negative (N) dhe përgjigje që nuk raportojnë për ndryshim (E), në përqindje ndaj totalit të përgjigjeve në mënyrë që për çdo pyetje të krijohet vektori:

² Kampioni i VBB është pothuaj i fiksuar, pasi ai rishikohet për të përjashtuar ato biznese që nuk përgjigjen apo kanë mbyllur aktivitetin e tyre, për t'u zëvendësuar me biznese të ngjashme në madhësi dhe në natyrën e aktivitetit ekonomik. Procesi i rishikimit është i kufizuar; zëvendësimi i bizneseve nuk e tejkalon gjatë një viti 10% të kampionit të fiksuar.

$X=(P, E, M)$ ku $P+N+E=100$

2.3 Llogaritja e balancave

Llogaritja e balancave është metoda tradicionale e agregimit dhe kuantifikimit të informacionit me karakter cilësor të vrojttimeve. Balancat janë diferenca midis përgjigjeve pozitive dhe negative, të shprehura në përqindje. Në varësi të alternativave të një pyetjeje, për pyetje me 3 alternativa; “pozitive” (“rritur”, “përmirësuar”, “më shumë” etj.), “neutrale” (“pa ndryshuar”, “njësoj”, “mjaftueshëm”) dhe “negative” (“ulur”, “keqësuar”, “më pak”), balanca llogaritet si:

$$B = P - N$$

Ku:

B-balanca e pyetjes individuale;

P-përqindja e përgjigjeve pozitive;

N-përqindja e përgjigjeve negative.

Në rastin e pyetjeve me 5 alternativa për shembull (“rritur shumë”, “rritur”, “pa ndryshim”, “ulur” dhe “ulur shumë”) balancat llogariten bazuar në mesataret e peshuara. Duke shënuar me PP dhe NN alternativat “rritur shumë” dhe “ulur shumë”, balanca llogaritet si më poshtë:

$$B = (PP+1/2P) - (1/2N+NN)$$

Ku $PP+P+E+N+NN=100$

Nisur nga të dyja mënyrat më lart për llogaritjen e balancave, vlerat që ato marrin luhaten nga -100, kur të gjitha përgjigjet janë dhënë negative (ose ato më negativet në rastin e pyetjeve me 5 alternativa), në +100, kur të gjitha përgjigjet janë dhënë pozitive (ose ato më pozitivet).

Pasi llogariten balancat për secilën pyetje të pyetësorit të biznesit, ato rregullohen sezonalisht, përpara se seritë e rregulluara sezonalisht të përpunohen më tej. Pyetjet e pyetësorit të konsumatorit nuk rregullohen sezonalisht, pasi seritë e këtij vrojtimi nuk kanë shfaqur ecuri të dukshme sezonale.

3. Llogaritja e treguesve të agreguar të besimit

Bazuar në rezultatet e detajuara -balancat e çdo pyetjeje- llogariten disa tregues të agreguar. Së pari, për çdo sektor (industri, ndërtim dhe shërbime) llogaritet treguesi i besimit (TB), i cili kombinon balancat e pyetjeve për sektorin përkatës. TB për çdo sektor është llogaritur si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht³, por jo të

³ Me përjashtim të treguesit të besimit të konsumatorëve, i cili është ndërtuar si mesatare e thjeshtë e balancave të parregulluara për sezonalitetin.

standardizuara, të pyetjeve specifike të zgjedhura nga pyetësi i secilit sektor. TB japin informacion lidhur me zhvillimet ekonomike në sektorë të ndryshëm. Së dyti, llogaritet treguesi i tendencës ekonomike (TTE), i cili kombinon balanca nga 4 sektorë (industri, ndërtim, shërbime dhe konsumatorët) duke synuar të kapë aktivitetin e përgjithshëm të ekonomisë në vend.

Treguesit e besimit për secilin sektor llogariten si mesatare e thjeshtë e balancave të zgjedhura, të rregulluara sezonalisht⁴. Balancat për ndërtimin e treguesi të agreguar për secilin sektor janë zgjedhur në mënyrë të tillë, që të kenë një lidhje sa më të fortë me serinë e referencës. Si seri reference janë përdorur seri të prodhimit të brendshëm bruto sipas sektorëve dhe indeksi i shitjeve të ekonomisë. Balancat nuk janë standardizuar para agregimit.

Bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB për secilin sektor, ndërtohet TTE, me ndryshimin që balancat standardizohen para agregimit⁵.

3.1 Treguesi i Besimit të Industrisë

Treguesi i besimit të industrisë është llogaritur si mesatarja aritmetike (në pikë përqindje) e përgjigjeve të pyetjeve mbi prodhimin, mbi punësimin dhe mbi gjendjen e inventarëve (balanca e marrë me shenjë të kundërt). Balancat e këtyre pyetjeve janë të rregulluara sezonalisht.

Pyetjet (shiko aneksin për pyetësin e plotë):

P.10 Si është paraqitur ecuria e prodhimit në firmën tuaj në periudhën?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

P.12 Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në inventarin e firmës tuaj gjatë periudhës?

1. Është rritur
2. S'ka ndryshime
3. Ka pësuar rënie

P.16 Si ka ndryshuar niveli i punësimit në firmën tuaj gjatë periudhës?

1. Është rritur
2. S'ka ndryshime
3. Ka pësuar rënie

⁴ Përjashtim bëjnë balancat e vrojtimit të konsumatorëve, të cilat nuk janë të rregulluara sezonalisht.

⁵ Standardizimi i balancave (zbritet mesatarja dhe pastaj pjesëtohet me devijimin standard) ka për qëllim të shmangë mundësinë që balancat/seritë me amplitudën më të theksuar, të dominojnë treguesin e agreguar.

3.2 Treguesi i Besimit të Ndërtimit

Treguesi i besimit të ndërtimit është llogaritur si mesatarja aritmetike (në pikë përqindjeje) e përgjigjeve të pyetjeve mbi prodhimin, mbi kërkesën dhe mbi punësimin. Balancat e këtyre pyetjeve janë të rregulluara sezonalisht.

Pyetjet (shiko aneksin për pyetëtorin e plotë):

P.10 Si është paraqitur ecuria e prodhimit në firmën tuaj në periudhën?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

P.6 Si është paraqitur kërkesa për mallrat dhe shërbimet tuaja për periudhën?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

P.16 Si ka ndryshuar niveli i punësimit në firmën tuaj gjatë periudhës?

1. Është rritur
2. S'ka ndryshime
3. Ka pësuar rënie

3.3 Treguesi i Besimit të Shërbimeve

Treguesi i besimit të shërbimeve është llogaritur si mesatarja aritmetike (në pikë përqindjeje) e përgjigjeve të pyetjeve mbi klimën e biznesit, mbi punësimin dhe mbi situatën financiare. Balancat e këtyre pyetjeve janë të rregulluara sezonalisht.

Pyetjet (shiko Aneksin për pyetëtorin e plotë):

P.3 Si paraqitet ecuria e përgjithshme e firmës tuaj në periudhën ...?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

P.16 Si ka ndryshuar niveli i punësimit në firmën tuaj gjatë periudhës?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

P.23 Si ka qenë gjendja financiare e firmës tuaj në periudhën?

1. Më e mirë
2. E njëjtë
3. E përkeqësuar

3.4 Treguesi i Besimit të Konsumatorëve

Treguesi i besimit të konsumatorëve është llogaritur si mesatarja aritmetike (në pikë përqindjeje) e përgjigjeve të pyetjeve mbi situatën financiare të pritur, situatën ekonomike të pritur, blerjet dhe mundësitë për kursim. Balancat e këtyre pyetjeve nuk janë të rregulluara sezonalisht.

Pyetjet (shiko aneksin për pyetësoin e plotë):

P.2 Si prisni të ndryshojë situata financiare e familjes tuaj gjatë 3 muajve të ardhshëm?

1. Do të përmirësohet shumë
2. Do të përmirësohet
3. Nuk do të ndryshojë
4. Do të keqësohet
5. Do të keqësohet shumë

P.4 Si prisni të ndryshojë situata e përgjithshme ekonomike në vend gjatë 3 muajve të ardhshëm?

1. Do të përmirësohet shumë
2. Do të përmirësohet
3. Nuk do të ndryshojë
4. Do të keqësohet
5. Do të keqësohet shumë

P.9 A mendoni se tani është koha më e mirë për të bërë blerje në shuma të mëdha (si për shembull, mobilie, elektro-shtëpiake etj.)?

1. Po, tani është koha më e mirë për këto lloj blerjesh
2. Nuk ka rëndësi koha kur bëhen këto blerje
3. Jo, nuk është kohë e mirë. Këto blerje duhen lënë për më vonë

P. 13 Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan më me saktësi gjendjen aktuale financiare të familjes tuaj?

1. Po marrim borxh
2. Për të përballuar shpenzimet po përdorim edhe kursimet
3. Mbulojmë shpenzimet vetëm me të ardhurat
4. Po kursejmë pak
5. Po kursejmë shumë

3.5 Treguesi i Tendencës Ekonomike

Treguesi i tendencës ekonomike (TTE) ka për qëllim të shprehë me anë të një treguesi të vetëm ndjesitë për aktivitetin ekonomik në vend të dy prej grupeve kryesore ekonomike, bizneseve dhe konsumatorëve. Në ndërtimin e treguesit të tendencës ekonomike janë përdorur 13 balancat e përdorura për ndërtimin e treguesve të besimit për secilin sektor.

Peshat e caktuara për të katër sektorët e ekonomisë, janë përcaktuar duke u bazuar në kontributin e sektorëve të industrisë, të shërbimeve dhe të ndërtimit në prodhimin e brendshëm bruto të vendit. Peshat e sektorit të shërbimeve është mbajtur e pandryshuar nga peshat që përdor Komisioni Evropian në ndërtimin e ESI (*Economic Sentiment Index*). Peshat sipas sektorëve janë si më poshtë:

Sektori i prodhimit	18.24%
Sektori i ndërtimit	15.44%
Sektori i shërbimeve	46.32%
Konsumatorët	20.00%

Peshat e sektorëve ndahen në mënyrë të barabartë midis pyetjeve. Balanca për secilën pyetje kalon në procesin e standardizimit, pasi është rregulluar për sezonalitet. Llogaritjet e detajuara të treguesit të tendencës ekonomike mbi bazën e komponentëve përbërës jepen më poshtë (balanca e çdo pyetje e llogaritur paraprakisht):

(1) Standardizimi

Për çdo tregues/balancë (j) llogaritet mesatarja (për secilën periudhë, t)

$$\bar{X}_j = \frac{1}{T} \sum_{t=1}^T X_{jt}$$

Për çdo tregues llogaritet devijimi standard, S_j

$$S_j = \sqrt{\frac{1}{T-1} \sum_{t=1}^T (X_{jt} - \bar{X}_j)^2}$$

Llogaritet treguesi i standardizuar

$$\frac{X_{jt} - \bar{X}_j}{S_j}$$

(2) Peshimi

Bazuar në peshat sipas sektorëve të përmendura më sipër, llogaritet treguesi i peshuar:

$$Z_t = \frac{\sum_j w_j Y_{jt}}{(\sum_j w_j)_t}$$

Emëruesi është shuma e peshave të një periudhe. Nëse në një periudhë janë të gjitha pyetjet atëherë emëruesi është 100, nëse jo është sa shuma e pyetje që disponohen në periudhën t.

(3) Treguesi i tendencës ekonomike-TTE

Llogaritet mesatarja e treguesit të peshuar në çdo periudhë, mesatarja e periudhave pasardhëse dhe asaj aktuale. Më pas llogaritet devijimi standard i treguesit të peshuar në çdo periudhë.

Llogaritet TTE nëpërmjet formulës më poshtë:

$$TTE = \left(\frac{Z_t - \bar{Z}}{S_z} \right) * 10 + 100$$

4. Publikimi i rezultateve

Rezultatet e vrojtimit do të publikohen 45 ditë kalendrike pas tremujorit referencë (shiko aneks 2), në datë 15 (ose dita e punës më e afërt e datës 15) të muajt të dytë të tremujorit të ardhshëm. Kalendari i publikimit gjendet në www.bankofalbania.org/publikime/vrojtimet

Aneks 1.

A. Pyetësori i bizneseve⁶

1. Si e vlerësoni ecurinë e ekonomisë në vend për tremujorin aktual?

1. Në rritje
2. E njëjtë
3. Në rënie

2. Si mendoni se do të jetë ecuria e ekonomisë në tremujorin e ardhshëm?

1. Në rritje
2. E njëjtë
3. Në rënie

3. Si paraqitet ecuria e përgjithshme e firmës tuaj në tremujorin aktual?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

4. Si mendoni se do të paraqitet aktiviteti ekonomik i firmës tuaj në tremujorin e ardhshëm?

1. Në rritje
2. I njëjtë
3. Në rënie

5. Renditni faktorët e mëposhtëm të cilët ndikojnë aktivitetin e firmës tuaj: (zgjidhni nga 1-5 për secilin faktor, ku 1 është niveli më i ulët i rëndësisë dhe 5 niveli më i lartë):

a. Kuadri ligjor dhe institucional	1 2 3 4 5
b. Marrëdhëniet me bankat	1 2 3 4 5
c. Klima e brendshme politike	1 2 3 4 5
d. Gjendja e rendit dhe e sigurisë	1 2 3 4 5
e. Probleme me infrastrukturën	1 2 3 4 5
f. Probleme me energjinë elektrike	1 2 3 4 5
g. Korrupsioni dhe ekonomia joformale	1 2 3 4 5
h. Të tjera (specifiko)	1 2 3 4 5

6. Si është paraqitur kërkesa për mallrat dhe shërbimet tuaja për tremujorin aktual?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

7. Si mendoni do të paraqitet kërkesa për mallrat dhe shërbimet e firmës tuaj në tremujorin e ardhshëm?

1. Në rritje
2. E njëjtë
3. Në rënie

⁶ Pyetësori i shërbimeve nuk përfshin pyetjet mbi prodhimin dhe gjendjen e inventarëve.

8. Në rast se keni aktivitet eksporti, si është paraqitur kërkesa për eksporte për mallrat dhe shërbimet tuaja?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

9. Si mendoni do të paraqitet kërkesa për eksporte për mallrat dhe shërbimet tuaja për tremujorin e ardhshëm?

1. Në rritje
2. E njëjtë
3. Do të pësojë rënie

10. Si është paraqitur ecuria e prodhimit në firmën tuaj?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

11. Si mendoni do të jetë ecuria e prodhimit në firmën tuaj në tremujorin e ardhshëm?

1. Në rritje
2. E njëjtë
3. Në rënie

12. Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në inventarin e firmës tuaj gjatë periudhës aktuale?

1. Është rritur
2. S'ka ndryshime
3. Ka pësuar rënie

13. Çfarë ndryshimesh mendoni se do të ndodhin në inventarin e firmës tuaj?

1. Do të rritet
2. S'do të ndryshojë
3. Do të pësojë rënie

14. Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në çmimet e prodhimit ?

1. Janë rritur
2. S'kanë ndryshuar
3. Kanë pësuar rënie

15. Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet e prodhimeve tuaja?

1. Do të rriten
2. S'do të ndryshojnë
3. Do të bien

16. Si ka ndryshuar niveli i punësimit në firmën tuaj?

1. Është rritur
2. Nuk ka ndryshuar
3. Ka pësuar rënie

17. Si mendoni se do të ndryshojë niveli i punësimit në firmën tuaj?

1. Do të rritet
2. S'do të ndryshojë
3. Do të pësojë rënie

18. Në cilin nga grupet e të punësuarve keni më shumë mungesa:
1. Punonjës të specializuar
 2. Nivel drejtues/mbikëqyrës
 3. Punëtorë të tjerë
19. Si ka ndryshuar niveli i pagës bruto (mesatare për punëtor)?
1. Eshtë rritur
 2. Nuk ka ndryshuar
 3. Ka pësuar rënie
21. Si mendoni se do të ndryshojë niveli i pagës bruto (mesatare për punëtor)?
1. Do të rritet
 2. S' do të ndryshojë
 3. Do të pësojë rënie
22. Si ka qenë konkurrenca në sektorin tuaj në tremujorin e kaluar?
1. Më e madhe
 2. E njëjtë
 3. Më e ulët
23. Si ka qenë gjendja financiare e firmës tuaj?
1. Më e mirë
 2. E njëjtë
 3. E përkeqësuar
24. Si paraqitet kapaciteti prodhues, krahasuar me 3 muaj me parë?
1. Më i lartë
 2. I njëjtë
 3. Më i ulët
25. Në çfarë mase po e shfrytëzoni aktualisht kapacitetin prodhues në aktivitetin tuaj?
_____ në % të kapacitetit të plotë
26. Duke marrë parasysh kërkesën aktuale dhe pritjet për (kontratat apo porositë) 12 muajt e ardhshëm, si e vlerësoni kapacitetin aktual të prodhimit/shërbimit?
1. I tepërt
 2. I mjaftueshëm
 3. Aspak i mjaftueshëm
27. Si janë paraqitur porositë (kontratat porositëse)?
1. Më tepër se mjaftueshëm (më shumë se normalja)
 2. Mjaftueshëm (normal për periudhën)
 3. Jo mjaftueshëm (më pak se normalja)
28. Si mendoni do të paraqiten porositë (kontratat porositëse) për tremujorin e ardhshëm?
1. Më tepër se mjaftueshëm (më shumë se normalja)
 2. Mjaftueshëm (normal për periudhën)
 3. Jo mjaftueshëm (më pak se normalja)
29. Sa muaj prodhim (shërbim) keni të siguruar ju me kontratat porositëse në tërësi?

Prodhimi (shërbimi) ynë është i siguar për _____ muaj

30. Cilët janë faktorët kryesorë që kufizojnë shfrytëzimin e kapaciteteve tuaja prodhuese në biznesin tuaj?

1. Asnjë
2. Kërkesë jo e mjaftueshme
3. Pamjaftueshmëri në forca pune të kualifikuara
4. Pamjaftueshmëri në materiale/makineri/hapësira
5. Kufizime financiare
6. Të tjera, specifikoni _____

31. Nëse keni kufizime financiare si gjykoni t'i përballoni ato?

1. Me kredi bankare
2. Me kredi të institucioneve jobanka
3. Kredi nga të tretët
4. Porosi me parapagim
5. Të tjera, specifiko _____

B. Pyetësi i konsumatorëve

1. Si ka ndryshuar situata financiare e familjes tuaj në tremujorin aktual krahasuar me 3 muaj më parë?

1. Është përmirësuar shumë
2. Është përmirësuar
3. Nuk ka ndryshuar
4. Është keqësuar
5. Është keqësuar shumë

2. Si prisni të ndryshojë situata financiare e familjes tuaj gjatë 3 muajve të ardhshëm?

1. Do të përmirësohet shumë
2. Do të përmirësohet
3. Nuk do të ndryshojë
4. Do të keqësohet
5. Do të keqësohet shumë

3. Si ka ndryshuar situata e përgjithshme ekonomike në vend në tremujorin aktual krahasuar me 3 muaj më parë?

1. Është përmirësuar shumë
2. Është përmirësuar
3. Nuk ka ndryshuar
4. Është keqësuar
5. Është keqësuar shumë

4. Si prisni të ndryshojë situata e përgjithshme ekonomike në vend gjatë 3 muajve të ardhshëm ?

1. Do të përmirësohet shumë
2. Do të përmirësohet
3. Nuk do të ndryshojë
4. Do të keqësohet
5. Do të keqësohet shumë

5.1. Si ka ndryshuar kostoja mesatare e jetesës në tremujorin aktual krahasuar me 3 muaj më parë?

1. Është rritur jashtëzakonisht shumë
2. Është rritur ndjeshëm
3. Është rritur pak
4. Është e njëjtë
5. Është ulur

5.2. Si ka ndryshuar kostoja mesatare e jetesës në tremujorin aktual krahasuar me 1 vit më parë?

1. Është rritur jashtëzakonisht shumë
2. Është rritur ndjeshëm
3. Është rritur pak
4. Është e njëjtë
5. Është ulur

6.1. Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet gjatë 3 muajve të ardhshëm ?

1. Do të rriten me ritëm më të lartë
2. Do të rriten me të njëjtin ritëm
3. Do të rriten me ritëm më të ulët
4. Nuk do të ndryshojnë
5. Do të ulen pak

6.2. Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet në 12 muajt e ardhshëm?

1. Do të rriten me ritëm më të lartë
2. Do të rriten me të njëjtin ritëm
3. Do të rriten me ritëm më të ulët
4. Nuk do të ndryshojnë
5. Do të ulen pak

7. Sa mendoni se do të ndryshojnë çmimet në 12 muajt e ardhshëm?

1. Do të rriten 0-2%
2. Do të rriten 2-4%
3. Do të rriten mbi 4%
4. Do të ulen

8. Si mendoni se do të ndryshojë niveli i papunësisë gjatë 6 muajve të ardhshëm?

1. Do të rritet shumë
2. Do të rritet pak
3. Nuk do të ndryshojë
4. Do të ulet pak
5. Do të ulet shumë

9. A mendoni se tani është koha më e mirë për të bërë blerje në shuma të mëdha (si për shembull, mobilie, elektro-shtëpiake etj.)?

1. Po, tani është koha më e mirë për këto lloj blerjesh
2. Nuk ka rëndësi koha kur bëhen këto blerje
3. Jo, nuk është kohë e mirë. Këto blerje duhen lënë për më vonë

10. Krahasuar me 3 muajt e fundit, në 3 muajt e ardhshëm, a prisni të shpenzoni më shumë apo më pak për blerje në shuma të mëdha (si për shembull mobilie, elektro-shtëpiake etj.)?

1. Shumë më tepër
2. Pak më tepër
3. Pak a shumë njësoj
4. Më pak
5. Shumë më pak

11. Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme ekonomike, a mendoni se tani është:

1. Kohë shumë e mirë për të kursyer
2. Kohë e mirë për të kursyer
3. Kohë e pafavorshme për të kursyer
4. Kohë shumë e pafavorshme për të kursyer

12. A mendoni se gjatë 3 muajve të ardhshëm të kurseni do të jetë...:

1. Shumë e mundshme
2. E mundshme
3. E pamundur
4. Krejtësisht e pamundur

13. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan më me saktësi gjendjen aktuale financiare të familjes tuaj?

1. Po marrim borxh
2. Për të përballuar shpenzimet po përdorim edhe kursimet
3. Mbulojmë shpenzimet vetëm me të ardhurat
4. Po kursejmë pak
5. Po kursejmë shumë

Aneks 2.

Kalendari i vrojtimit të biznesit dhe të konsumatorit, viti 2009.

Data e marrjes (DPM)	Treguesi	Periudha e referencës	Data e publikimit	Vonesa ndaj periudhës referuese	Njësia që kryen vrojtimin në terren
20 janar	IBB	T 4 - 2008	16 shkurt	46 ditë	INSTAT
20 janar	IBK	T 4 - 2008	16 shkurt	46 ditë	INSTAT
20 prill	IBB	T 1 - 2009	15 maj	45 ditë	INSTAT
20 prill	IBK	T 1 - 2009	15 maj	45 ditë	INSTAT
20 korrik	IBB	T 2 - 2009	14 gusht	44 ditë	INSTAT
20 korrik	IBK	T 2 - 2009	14 gusht	44 ditë	INSTAT
20 tetor	IBB	T 3 - 2009	16 nëntor	46 ditë	INSTAT
20 tetor	IBK	T 3 - 2009	16 nëntor	46 ditë	INSTAT